



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr. 31/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Socijal Demokratika Unija (SDU), me seli në Prizren, parashtruar kundër subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.31/2025, e datës 22.12.2025, parashtruar nga Subjektit Politik Socijal Demokratska Unija (SDU), me seli në Prizren, paraqitur kundër Subjektit Politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 22.12.2025 në PZAP-i, është parashtruar ankesë nga subjekti politik Socijal Demokratska Unija (SDU), me seli në Prizren, në të cilën pretendohet se subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes së Subjekteve Politike gjatë fushatës zgjedhore Paraqes ankesë kundër partisë pasi që në mitingun politik të kësaj partie kanë marrë pjesë fëmijë të mitur, gjë që duket qartë në fotot e publikuara në faqen zyrtare të Facebook-it të kryetares së partisë, Emilija Redzeqi. Parashtruesi i ankesës thekson se përmbajtja e publikuar tregon qartë praninë dhe përfshirjen e fëmijëve në një ngjarje politike dhe aktivitete promovimi. Me këtë veprim parashtruesi i ankesës mendon se një sjellje e tillë përfaqëson shfrytëzim të personave të mitur për qëllime politike, shkelje të Kodit të Sjelljes së Subjekteve Politike, të përkrahësve dhe kandidatëve të tyre, shkelje të parimeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe të fushatës së ndershme zgjedhore. I njëjti kërkon që PZAP-i, të vërtetojë përgjegjësinë e subjektit politik dhe të personit përgjegjës, të urdhërojë heqjen e fotove të diskutueshme, të jepe sanksionet e duhura në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS) thekson se objekti i ankesës është një fotografi e marrë gjatë një ngjarjeje publike – hapjes së fushatës parazgjedhore të NDS-së. Në të gjendet një i mitur madhor (mbi 15 vjeç), anëtar i familjes së ngushtë të kandidatit në listën e NDS-së, i cili ka marrë pjesë në ngjarje ekskluzivisht për të dhënë mbështetje familjare prindit të tij. Ngjarja ishte me karakter publik dhe të hapur, pa asnjë kufizim aksesit. Prania e të miturit madhor nuk ishte e organizuar, e planifikuar, e ftuar ose në asnjë mënyrë nisur nga ana e subjektit politik NDS, por përfaqëson ekskluzivisht një vendim personal dhe familjar.

Rreth vlerësimit juridik të pretendimeve në ankesë thekson se legjislacioni zgjedhor në fuqi i Republikës së Kosovës nuk parashikon ndalim të pranisë pasive të një të mituri madhor në një mbledhje politike publike, sidomos kur ai është në shoqëri të prindit ose anëtarëve të familjes dhe kur nuk ka instrumentalizim politik. Në rastin konkret, i mituri madhor nuk mbajti fjalim publik, nuk mori pjesë në parulla, brohoritje ose thirrje për votim, nuk mbarti as shpërndau materiale promocionale, nuk ishte pjesë e programit të organizuar të fushatës, nuk u përdor për qëllime promocionale, mediatike ose politike. Prandaj, nuk janë plotësuar elementet ligjore të sjelljes së ndaluar në kuptimin e nenit 30 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Sipas nenit 118 të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme, barra e dëshmimit të pretenduar e shkeljes qëndron tërësisht tek paraqitësi. Subjekti politik SDU në rastin konkret nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi me të cilën do të konfirmonte ekzistencën e veprimtarive aktive nga ana e subjektit politik NDS me qëllim të instrumentalizimit politik të të miturit madhor.

Në praktikën e deritanishme dhe të vendosur të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, është marrë një qëndrim i qartë se shkelja e legjislacionit zgjedhor në lidhje me personat e mitur mund të konstatohet ekskluzivisht në rastet e angazhimit aktiv të dëshmueshëm të miturit në fushatë nga ana e subjektit politik. PZAP-ja në disa vendime të mëparshme ka vlerësuar se prania pasive e një të mituri madhor në një ngjarje politike publike, sidomos në kontekst familjar dhe pa asnjë rol fushatës, nuk përfaqëson shkelje të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, as bazë për dhënien e sanksioneve. NDS-ja nuk e kundërshton se bëhet fjalë për një person të mitur, por thekson se është fjala për një të mitur madhor – fëmijë i kandidatit, prania e të cilit ka ekskluzivisht karakter familjar dhe personal. Kjo rrethanë plotësisht konfirmon mungesën e çdo elementi të fushatës ose promocional në praninë e tij. Propozon që PZAP-i, të marrë vendimin përfundimtar me të cilin ankesa e subjektit politik SDU të refuzohet si e pabazuar, të konstatohet se në veprimtaritë e subjektit politik Nova demokratska stranka nuk ka ndodhur shkelje e legjislacionit zgjedhor, procedura për ankesën në fjalë të përfundojë pa dhënë sanksione.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore si dhe përgjigjen në ankese, gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS) nuk ka bere shkelje të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, i cili përcakton se*Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.* Mbi bazën e provave me saktësisht fotografitë e paraqitura nuk mund të vërtetohet se fëmijët kanë qenë pa përcjelljen e prindërve. Në fotografitë e ofruara si prova me fëmijë shihen edhe persona madhor që mund të konsiderohen se kanë qene prindërit e tyre. Ne anën tjetër neni 117 par. 3 LZP, kur vendos

për ankesat PZAP-i, bazohet në prova të qarta dhe bindëse. Prandaj nuk qëndrojnë pretendimet e theksuara në ankese.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, pasi që ankesa e parashtuesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.31/2025 më datën 24.12.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.